

SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT



Nr.
2

RAPORTI PUBLIK 2019

www.shish.gov.al



PËRMBAJTJA

2	Paraqitje e Raportit Publik 2019 nga Drejtori i SHISH-it
4	Gjendja e sigurisë në Republikën e Shqipërisë
4	Krimi i organizuar
6	Krimet në ekonomi
7	Korrupsioni
8	Kërcënimi kibernetik
9	Siguria energjetike
10	Gjendja politike dhe e sigurisë në rajon
10	Vështrim i përgjithshëm
12	Terrorizmi
13	Kërcënimi terrorist në rajon dhe në vendin tonë
14	Radikalizimi drejt ekstremizmit të dhunshëm
16	Modus Operandi e organizatave terroriste
17	Emigracioni i jashtëligjshëm
18	Një përpjekje e pasuksesshme
20	Aktiviteti i shërbimeve të inteligjencës me qëndrim jomiqësor
20	Çfarë janë aktivitetet hibride?
22	Produkti informativ
24	Zhvillimet IT&T dhe digjitalizimi
25	Lajmi i rremë dhe kërcënimi për sigurinë kombëtare
28	Pyetje dhe përgjigje rreth lajmit të rremë
30	Buxheti dhe menaxhimi financiar i SHISH-it
31	Burimet njerëzore
33	Bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit
35	SHISH-i në nisma sociale dhe humanitare
37	Lista e shkurtesave

Paraqitje e Raportit Publik 2019

Të dashur lexues,

Në cilësinë e Drejtorit të SHISH-it, kam kënaqësinë t'ju paraqes Raportin e Dytë Publik të SHISH-it, i cili përqendrohet te prioritetet, sfidat, arritjet, problematikat e vitit 2019 dhe objektivat për të ardhmen.

Vitin e kaluar, bazuar në praktikat më të mira, Shërbimi publikoi dokumentin e parë, në lidhje me objektin dhe drejtimit kryesore të punës, detyrat ligjore të Shërbimit, menaxhimin dhe kontrollin, bashkëpunimin ndër-institucional e ndërkombëtar, si dhe produktin informativ për institucionet e larta shtetërore e agjencitë ligjzbatuese, në funksion të Sigurisë Kombëtare të vendit. Kam kënaqësinë të ndaj me ju faktin se, botimi i Raportit të Parë është mirëpritur nga opinioni publik, specialistët e fushës, institucionet shtetërore e partnerët ndërkombëtarë, duke konfirmuar faktin se hapja dhe transparenca është një hap në rrugën e duhur. Kontributi në fuqizimin e sigurisë kombëtare kalon edhe përmes rritjes së besimit qytetar te Shërbimi ynë.

Gjatë vitit 2019, Shërbimi është përballur me sfida për mirëfunksionimin e strukturave efektive operacionale e analitike për t'u ndeshur me aktivitetet anti-ligjore. Avancimi i sistemit të digjitalizimit dhe përmirësimi i kapaciteteve teknologjike, rekrutimi dhe trajnimi i punonjësve të rinj, trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve në detyrë, rritja e kapaciteteve dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, përmirësimi i kuadrit ligjor, thellimi i bashkëpunimit me institucionet e sigurisë kombëtare dhe agjencitë ligjzbatuese, bashkëpunimi me organet e reja të drejtësisë dhe shërbimet partnere, ishin përparësitë tona.

Në përmbushje të detyrave ligjore, kërkesave dhe prioriteteve nga institucionet e larta shtetërore, gjatë 2019-ës, SHISH-i ka realizuar objektivat në fushën e kundërzbu-

zbulimit e zbulimit, duke thelluar bashkëpunimin me institucionet qendrore e lokale.

Veprimtaria e shërbimeve jo-mike dhe ekstremizmit të dhunshëm, kërcënimet terroriste, situata politike dhe e sigurisë në rajon e më gjerë, krimi i organizuar, krimet në ekonomi dhe korrupsioni, kanë vijuar të jenë shqetësimet kryesore ndaj sigurisë kombëtare. Në këtë kuadër, SHISH-i ka përgatitur dhe ndarë produkt informativ analitik e operacional në nivel qendror e lokal, brenda dhe jashtë vendit, me agjencitë ligjzbatuese e shërbimet partnere, duke dhënë kontribut të vlerësuar në parandalimin dhe goditjen e veprimtarive antiligjore.

Mjedisi i ndryshueshëm i sigurisë, kërcënimet klasike, kibernetike, hibride e transnacionale, shtrirja e veprimtarive antiligjore përtej kufijve zyrtarë, kërkon bashkëpunim në nivel rajonal e ndërkombëtar. Për t'u përballur me këto dukuri, Shërbimi ka vijuar dhe thelluar bashkëpunimin me shërbimet dhe agjencitë informative partnere, me të cilat ndajmë të njëjtat vlera dhe përballimi me të njëjtat kërcënime. SHISH-i luan rol aktiv në nxitjen dhe thellimin e bashkëpunimit rajonal, është kontribuues në NATO dhe ka çuar përpara bashkëpunimin me shërbimet informative të vendeve të BE-së.

Kontributi i SHISH-it ka marrë vlerësimet më të larta nga instancat shtetërore dhe politikëbërëse, falënderime nga agjencitë ligjzbatuese, shërbimet partnere dhe strukturat e sigurisë dhe inteligjencës së NATO-s.

Gjatë 2019-ës, ne jemi përqendruar te rritja e kapaciteteve dhe menaxhimi i burimeve njerëzore. Punësimi i punonjësve të rinj është bazuar në plotësimin e kriterëve ligjore, në rregullat e brendshme të Shërbimit dhe në cilësitë e aftësisë individuale të aplikuesve, duke përzgjedhur individë të përshtatshëm,

nga Drejtori i SHISH-it

të formuar e motivuar për të shërbyer me përkushtim në luftën ndaj veprimtarive kriminale, për sigurinë e qytetarëve dhe sigurinë kombëtare.

Dua të shfrytëzoj këtë rast, t'u bëj thirrje dhe të nxis individë të rinj, të shkolluar dhe të motivuar, të gatshëm për t'u përballur me sfidat dhe për të sakrifikuar, që të aplikojnë për t'iu bashkuar SHISH-it. Shërbimi garanton një proces profesional e transparent përzgjedhjeje, duke u dhënë mundësi të barabarta të gjithë kandidatëve që do të kualifikohen për të kaluar një procedurë të tillë.

Arritjet e rezultatet gjatë vitit 2019 përbëjnë një trase shumë të mirë për të ndërtuar të ardhmen. Gjatë 2020-ës, SHISH-i do të vijojë punën me përkushtim e profesionalizëm për monitorimin, informimin në kohë dhe parandalimin e kërcënimeve terroriste ndaj individëve, grupeve e entiteteve të ndryshme, për realizimin e qëllimeve të tyre kriminale, ndaj kërcënimeve kibernetike, kriminit të organizuar, korrupsionit, ndaj shërbimeve sekrete kundërshtarë, që përbëjnë rrezik për sigurinë kombëtare, rajonale e kolektive. Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, modernizimi teknologjik, trajnimet nga specialistë të fushës dhe mbështetja logjistike për realizimin e këtyre objektivave, janë disa nga sfidat aktuale dhe të ardhshme të Shërbimit.

Po e përfundoj këtë paraqitje të shkurtër, duke shprehur falënderimet e mia për institucionet më të larta shtetërore, agjencitë ligjzbatuese dhe partnerët, për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë agjencisë tonë në realizimin me sukses të misionit të saj. Në sajë të kësaj mbështetjeje e



bashkëpunimi, Republika e Shqipërisë do të jetë një vend më i sigurt dhe më i prosperuar. Me këtë rast, dua të siguroj përsëri autoritetet shtetërore dhe opinionin publik se, SHISH-i do të vazhdojë të jetë i angazhuar dhe i përkushtuar në realizimin me profesionalizëm dhe përkushtim të detyrave të tij, në zbatim të Kushtetutës, kuadrit ligjor dhe respektimit të të drejtave e lirive themelore të individit.

Së fundmi, dua të shpreh falënderime dhe mirënjohje për të gjithë punonjësit e Shërbimit. Janë pikërisht ata që punojnë me përkushtim, përgjegjshmëri e profesionalizëm, për të forcuar sigurinë qytetare e kombëtare, për të ruajtur vlerat e lirisë, rendit kushtetues e demokratik të vendit tonë.

Helidon Bendo

Drejtor i Shërbimit Informativ të Shtetit

GJENDJA E SIGURISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË



KRIMI I ORGANIZUAR

Krimi i organizuar në vend, me lidhje rajonale e ndërkombëtare, ka adoptuar mënyrat e veprimit në raport me forcën kundërvënëse të agjencive të zbatimit të ligjit. Format e krimit të organizuar, më të preferuara për grupet shqiptare, vijojnë të mbeten trafiku i drogave, trafiqet e tjera të paligjshme, krimet ekonomiko-financiare, kontrabanda dhe aktivitetet e paligjshme ndërkufitare. Deri tani, nuk janë evidentuar raste në të cilat

individë apo grupe të krimit të organizuar të veprojnë për llogari të organizatave terroriste apo të mbështesin aktivitete të kësaj natyre. Emëruesi i përbashkët për të gjitha grupet e rrjetet e krimit të organizuar mbetet pastrimi i parave dhe korrupsioni, me qëllim forcimin e lidhjes mes strukturave të paligjshme me ato të ligjshme.

Ndër format mbizotëruese të krimit të organizuar mbetet trafiku i drogës dhe përfshirja në drogat e forta.



Ky aktivitet nxitet dhe favorizohet nga:

1

Pozicionimi i elementëve kriminalë shqiptarë në vendet e origjinës së prodhimit të drogës, në pikat kyçe të shpërndarjes apo trafikimit të saj, pjesë e një zinxhiri për kontrollin e gjithë procesit, nga origjina në destinacion

2

Kërkesat në rritje të rrjeteve të trafikut të drogave të forta, përfshi rrjetet shqiptare, të vendosura në qendra të mëdha të vendeve të Evropës Perëndimore dhe në vendet e origjinës

3

Kërkesat e grupeve kriminale për kanabis sativa të kultivuar në Shqipëri

4

Fleksibiliteti dhe adoptueshmëria e lartë, “korrektesa” në marrëdhëniet me grupet e individët furnitorë të drogës

5

Të ardhurat financiare të gjeneruara nga aktiviteti kriminal ndër vite

Vlerat monetare dhe pasuria e përfituar nga veprimtaria kriminale ndër vite (favorizuar nga korrupsioni në sistemin e drejtësisë, pandëshkueshmëria apo niveli i ulët i saj), po përdoren nga këto grupe për zgjerimin e aktivitetit të narkotrafikut jashtë vendit, kryesisht në drejtim të drogave të forta. Individët kriminale që i kanë shpëtuar ndëshkimit, janë vendosur në vende të huaja dhe prej andej shërbejnë si ura lidhëse të trafikut me elementë kriminalë brenda vendit. Përveçse në vendet evropiane, janë aktivë edhe në vendet e origjinës së kokainës e heroinës, ku bashkëpunojnë me elementë kriminalë lokalë.

Kultivimi i kanabisit në vend, krahasuar me vitet e mëparshme, është reduktuar si rezultat i masave të forta kundër fenomenit, bashkëpunimit të thelluar mes agjencive të zbatimit të ligjit, ngritjes dhe funksionimit të Task Forcave qendrore dhe lokale. Gjatë kësaj periudhe, është evidentuar ndryshimi i mënyrës së veprimit, që ka rezultuar në kultivim në sipërfaqe të vogla, të shpërndara gjeografikisht. Vërehet zhvendosje e aktivitetit të kultivimit në ambiente të mbyllura në vend, vendet fqinje dhe ato evropiane. Ndërkohë ka vijuar trafiku i kanabisit dhe është rritur bashkëpunimi me grupe e individë kriminale në vendet e rajonit.

Linjat më të përdorura për trafikimin e kanabisit mbeten ato tokësore, detare por edhe ujore. Evidentohen raste të shkëmbimit të kanabisit me droga të forta, si heroinë dhe kokainë.

Evidentohet rritje e shkallës së konfliktualitetit dhe rivalitetit dhe përfshirje në disa aktivitete kriminale si pastrim i parave, lehtësim i emigracionit të jashtëligjshëm, gjobëvënie, etj. Për larje hesapesh, grupet kriminale përdorin edhe vrasës profesionistë me pagesë.

Grupet kriminale paraqiten me organizim

fluid, pragmatikë, të përfshirë në disa aktivitete të jashtëligjshme dhe me lidhje që mundësojnë ciklin e trafikut të drogës, duke filluar nga blerja në vendet prodhuese, trafikimi, shpërndarja dhe aftësia kundërvepruese për të eliminuar rreziqet. Përdorin identitete të ndryshme dhe disponojnë pasaporta origjinale ose false, nga disa vende evropiane.

Parandalimi dhe goditja e këtij aktiviteti kriminal është shoqëruar edhe me evidentim dhe sekuestrim të pasurive e parave të gjeneruara ndër vite nga ky aktivitet.

KRIMET NË EKONOMI

Krimet në ekonomi mbeten faktor me rrezikshmëri të lartë për rritjen e qëndrueshme ekonomike, besueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit financiar e atij ekonomik në vend. Përshpejtimi i globalizimit ekonomik, mbështetur në tregjet financiare globale dhe strategjitë e tregut të lirë, e kanë pakësuar rëndësinë e kufijve dhe kanë krijuar mundësi të reja për krimin ekonomik.

Ndër aktivitetet më

të përhapura të krimeve në ekonomi evidentohen mashtrimet në fushën e taksave dhe doganave, hartimi i faturave fiktive të shit-blerjes, krijimi i operatorëve ekonomikë fiktivë,

kontrabanda e mallrave të akcizës, pastrimi i parave të gjeneruara nga aktiviteti kriminal.

Faktorë favorizues evidentohen korrupsioni dhe niveli i informalitetit në ekonomi. Pavarësisht përpjekjeve serioze për reduktimin e informalitetit nëpërmjet modernizimit të shërbimeve dhe rritjes së ndëshkueshmërisë,

mbetet problematike shqetësuese, që vështirëson procesin e identifikimit të të ardhurave me origjinë të paligjshme dhe sekuestrimin apo konfiskimin e tyre.

Në vendin tonë, një sasi e konsiderueshme e parave “të pista” e ka origjinën nga aktiviteti kriminal ndër vite i individëve dhe grupeve të përfshira. Të ardhurat e fituara në mënyrë të paligjshme janë investuar në vijimin e aktiviteteve kriminale, si dhe në biznese të ligjshme. Sektorët mbizotërues për pastrimin e parave mbeten biznesi i ndërtimit, pasuritë e paluajtshme, hoteleri-turizmi, etj. Zonat bregdetare e ato urbane mbeten më tërheqëset, pasi ofrojnë potencial për kthimin shumëfish të investimit fillestar.



KORRUPSIONI

Korrupsioni (por edhe perceptimi mbi nivelin e tij) minon besimin e publikut te qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, cenon zhvillimin e vendit, forcimin e institucioneve, rritjen e qëndrueshme ekonomike, mbetet faktor me rrezikshmëri të lartë që ngadalëson dhe dëmton procesin e reformave për arritjen e standardeve drejt integritimit evropian, si dhe dekurajon investimet e brendshme e të huaja, të nevojshme për të krijuar mundësi punësimi për të gjithë.

Megjithë hapat pozitivë në luftën kundër korrupsionit, fokusit të shtuar të shtetit në kuadër të reformave dhe nismave

konkrete në këtë drejtim, kjo dukuri vijon të shfaqet problematike në sistemin e drejtësisë dhe disa segmente të administratës publike.

Për shkak të masave të shtuara kundër korrupsionit dhe reformës në drejtësi, elementë të sistemit të drejtësisë shfaqin kujdes të shtuar për të shmangur ekspozimin dhe lidhjet me elementë të besuar me akses direkt në Veting, si dhe dëshirë për të dëshmuar performancë në proceset gjyqësore të drejtuara prej tyre, përmes

formulimit të akuzave, zvarritjes së procedurave apo dhënies së vendimeve maksimale të parashikuara në ligj.

SHISH-i jep kontribut konkret në këtë drejtim për përfshirje të mund-

shme të elementëve të këtij sistemi në afera korruptive dhe në kuadër të Vetingut në drejtësi dhe Policinë e Shtetit.



KORRUPSIONI:



minon besimin e publikut te qeverisja e mirë dhe te sundimi i ligjit



cenon zhvillimin e vendit, forcimin e institucioneve, rritjen e qëndrueshme ekonomike



ngadalëson dhe dëmton procesin e reformave për arritjen e standardeve drejt integritimit evropian



dekurajon investimet e brendshme dhe të huaja, të nevojshme për të krijuar mundësi punësimi

KËRCËNIMI KIBERNETIK

Rritja e aftësive kibernetike e kundërshtarëve tanë, nënkupton kërcënim në rritje për sigurinë dhe stabilitetin politik dhe ekonomik. Aktiviteti në rritje në nivel global prek edhe vendin tonë, ku po ndodhin procese digjitalizuese në evolucion të shpejtë të shërbimeve shtetërore dhe joshtetërore. Shtetet kundërshtarë dhe shërbimet e tyre të inteligjencës zotërojnë kapacitete kibernetike për operacione në rrjetet kompjuterike, zhvillojnë kapacitete kibernetike ofensive, kryesisht për të mundur aktivitetet e spiunazhit dhe grumbullimin e inteligjencës.

Përballë kësaj dukurie, nevojitet ndërgjegjësimit për shkallën e rrezikut, nivelin e kërcënimit, metodologjitë e përdorura për të mbrojtur informacionin e klasifikuar, përditësim të procedurave të mbrojtjes në raport me ecurinë e formave dhe metodave të përdorura.

Gjithashtu, çdo projekt i ri digjitalizimi shtetëror apo privat duhet të shoqërohet me masa adekuate mbrojtëse. Për të fuqizuar mbrojtjen kibernetike, është rritur shkëmbimi dhe bashkëpu-

nimi në fushën e kibernetikës, investimet në burimet njerëzore, zhvillimi i kapaciteteve teknike, rritje e bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore me ato joshtetërore të fushës.

Trysnia mbi rrjetet e administrimit, ruajtjes e shpërndarjes së informacionit të klasifikuar, si pjesë e infrastrukturës kritike kombëtare,

do të rritet me përparimin e teknologjisë së informacionit. Rritja e shpejtësisë, performanca e komunikimit të fshehtë, besueshmëria, do të mundësojnë procese të reja industriale, logjistike të avancuar, inteligjencë artificiale dhe aplikacione për sigurinë. Kundërshtarë të mundshëm me gjasë do të kërkojnë të shfrytëzojnë këto dobësi.



SIGURIA ENERGJETIKE

Teknologjia e vjetërsuar, ndërvarësia, nevoja për diversifikim të burimeve, janë sfidat reale për garantimin e furnizimit me energji të sektorëve të ekonomisë në vendet e rajonit. Sigurimi i burimeve të tjera alternative është në vëmendjen e qeverive. Diversifikimi i burimeve energjetike dhe minimizimi i varësisë nga importet mbetet prioritet, pasi vendet e rajonit janë të varura nga importi i energjisë për qëllime konsumi të brendshëm dhe, si rrjedhim, janë të ndikuara nga pasojat ekonomike për shkak të çrregullimeve në furnizime.

Vendet e rajonit janë rruga e transportit të naftës dhe gazit për në vendet perëndimore. Si konsumatorë, por edhe si pjesë e korridoreve të tranzitit, projektet energjetike rrisin bashkëveprimin e vendeve ballkanike.

Shqipëria ka përmirësuar infrastrukturën ligjore për burimet energjetike, duke miratuar ligje dhe rregullore për energjinë dhe burimet alternative. Strategjia e Sigurisë Kombëtare (2014) i kushton një vëmendje të veçantë sigurisë energjetike. Strategjia Kombëtare e Energjisë (2018) bazohet në kriteret ligjore të BE-së

për energjetikën, jep garanci dhe konsolidon më tej projektet dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit.

Shqipëria ka kontribuar në krijimin e kushteve të përshtatshme dhe tregje për energjinë e pastër në vendet e Evropës Juglindore dhe BE-së. Ajo ka mbështetur projektin TAP në kuadrin e aleancave strategjike dhe partneritetit me BE. Projekti TAP (Greqi- Shqipëri-Itali), si një ndër projektet konkurruese të Korridorit Jugor të gazit, do të ndikojë në diversifikimin e energjisë. Vlerësohet si projekt i rëndësishëm së veçantë për BE-në, për transportimin e gazit nga Kaspiku në tregun evropian. TAP do të përmirësojë furnizimin dhe sigurinë energjetike në rajon. Projekti në Shqipëri është mirëpritur nga banorët dhe opinioni publik.


Rrjetet energjetike nuk kanë qenë target i organizatave terroriste. Vlerësojmë se mundësia për sulme terroriste kundër infrastrukturës energjetike, mbetet relativisht e ulët. Rreziku për sulme kibernetike nga aktorë shtetërorë kundër infrastrukturës në sektorin energjetik, nuk është i përjashtuar.



GJENDJA POLITIKE DHE E SIGURISË NË RAJON

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ballkani Perëndimor vijon të përballet me një sërë kërcënimesh të përbashkëta si:



Të gjithë këta faktorë ndikojnë në paqëndrueshmërinë sociale dhe pengojnë ecurinë e reformave demokratike.

Aktorët globalë, kundërshtarë të orientimit pro-perëndimor të vendeve të rajonit, përmes aktiviteteve të inteligjencës dhe atyre hibride, synojnë të dëmtojnë proceset integruuese, influ-

encojnë vendimmarrje mbi zhvillime politike të rëndësishme dhe të përçajnë vendimmarrjet kombëtare në raport me organizmat ndërkombëtare. Ata shfrytëzojnë problematikat e bartura ndërshtetërore, nxisin nacionalizma dhe ekstremizma për të krijuar avantazhe gjeo-ekonomike me synime afatgjata politike.

Spikatin si problematika konkrete:

- Zhvillimet e brishta politike dhe të sigurisë në rajon, retorikë e shtuar nacionaliste dhe qëndrime refraktare.
- Mungesa e përparimit në dialogun Kosovë-Serbi, me ndërmjetësimin e BE-së.
- Instrumentalizim i pakicave me synim ruajtjen e statuskuosë dhe nxjerrjen e përfitimeve politike.
- Përfshirja në afera korruptive e elitave politike.
- Çështjet e pazgjidhura në marrëdhëniet ndërshtetërore me ndikim në retorikën nacionaliste ekstreme, aktivitetet e lëvizjeve politike, shoqatave dhe asociacioneve me agjenda nacionaliste ekstreme dhe presione ndaj maxhorancave qeverisëse.
- Krimi i organizuar si kërcënim për rajonin, i cili mbetet rrugë tranzite, për grupet shumë-etnike dhe me lidhje ndërkombëtare. Individë e grupe nga diasporat ballkanike janë shndërruar në ura lidhëse mes krimit të organizuar rajonal me atë ndërkombëtar.
- Emigracioni i paligjshëm. Synon përdorimin e rajonit si tranzit drejt BE-së. Grupet që merren me trafikimin e qenieve njerëzore kanë shtuar aktivitetin, duke përfituar nga gjendja në kampet e pritjes, kapacitetet e reduktuara, përdorimi i dokumenteve të falsifikuara, bashkëpunimi me elementë kriminalë dhe rrjete të trafikut njerëzor, shfrytëzimi i pikave të dobëta në kufirin e gjelbër.
- Trafiku i armëve të zjarrit, municioneve luftarake apo mallrave me përdorim të dyfishtë mbetet karakteristikë e veprimtarive kriminale për përfitime financiare. Vërehet rritje e interesit nga individë dhe grupime kriminale për armë të sofistikuar, për interesa kriminale.
- Situata ekonomiko-sociale e vështirë dhe e shoqëruar me problematika të shumta, pavarësisht përpjekjeve të qeverive për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Niveli i lartë i korrupsionit, informaliteti, papunësia, minojnë besueshmërinë e publikut të institucionet dhe reformat. Efektet e reformave ekonomike nuk janë të prekshme nga publiku.

Spikatin si zhvillime pozitive dhe dëshmi të forta të dështimit të përpjekjeve të aktorëve globalë dhe lokalë me agjenda nacionaliste për të penguar proceset euroatlantike:

- Marrëveshja e Prespës
- Anëtarësimi i Malit të Zi në NATO
- Anëtarësimi i pritshëm i Maqedonisë së Veriut në NATO

TERRORIZMI

Terrorizmi vijon të përbëjë kërcënim për sigurinë në planin lokal, rajonal dhe global.

ISIL/DAESH, Al-Qaeda dhe grupe të lidhura me to do të vijojnë të përbëjnë kërcënimin kryesor për sigurinë ndërkombëtare. ISIL / DAESH, edhe pse ka humbur shtetin e vetëshpallur islamik, një sërë komanduesish dhe operativësh të lartë dhe reduktuar ndjeshëm burimet njerëzore luftarake, vlerësohet me kapacitete kërcënuese për sigurinë ndërkombëtare.

Organizata vlerësohet në fazë tranzicioni, mbetet e fokusuar në mbijetesën, riorganizimin, mbajtjen e moralit të mbështetësve, duke argumentuar humbjet si të përkohshme.

Vlerësojmë se mbetet e aftë financiarisht për të mbuluar shpenzimet operationale për aktivitete terroriste. Organizata vijon thirrjet për akte terroriste, pa shumë shpenzime financiare, por me impakt, kryesisht për



audiencën e saj online.

Aktiviteti i terrorist nga hapësira digjitale dhe rrjetet sociale duket se do jenë Modus operandi më i mundshëm i organizatës për nxitje, koordinim e mbështetje për akte terroriste do të jetë përdorimi i hapësirës digjitale dhe rrjeteve sociale. ISIL / DAESH do të vazhdojë të përfitojë nga aktet e dhunës të terroristëve vendas, të kthyerve dhe individëve të radikalizuar, që veprojnë si aktorë

të vetmuar apo si pjesë e qelizave të fjetura, për të rritur propagandën dhe për të radikalizuar e rekrutuar të tjerë.

Humbja e territoreve nga ISIL/DAESH, i jep kështu Al-Qaeda mundësi për të rifituar statusin e mëparshëm si lider i lëvizjes globale xhihadiste terroriste. Pavarësisht diferencave ideologjike dhe rivalitetit për dominim, pragmatizmi në bashkëpunim mes tyre me gjasë do të rritë nivelin e kërcënimit.





KËRCËNIMI TERRORIST NË RAJON DHE NË VENDIN TONË

Në rajon dhe vendin tonë nuk ka pasur akte terroriste. Përforcimi i masave kundër terrorizëm, reformat ligjore, implementimi i strategjive kundër ekstremizmit të dhunshëm, fokusi i shtuar i agjencive ligjzbatuese, rritja e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, kanë dhënë efekte parandaluese. Të dyja organizatat terroriste të mësipërme vijojnë të shënjestrojnë rajonin nëpërmjet propagandës, thirrjeve e nxitjes së mbështetësve për akte terrori.

Influencat e jashtme dhe faktorë të brendshëm për radikalizim drejt ekstremizmit të dhunshëm vijojnë të jenë të pranishme, por në nivele të reduktuara.

Prezenca e luftëtarëve të huaj terroriste nga rajoni në organizatat terroriste në zonat e konfliktit, përbën kërcënim afatgjatë për sigurinë. Raportimet e vrasjeve të figurave të rëndësishme të LHT-ve shqipfolës nga rajoni dhe vendi ynë, aktivë në koordinimin dhe nxitjen e kontakteve të vjetra për akte terroriste, arrestimi, gjykimi dhe dënimi i nxitësve dhe rekrutuesve të lidhur me organizatat terroriste, ka sjellë ulje të thirrjeve konkrete për akte terroriste. Vlerësojmë se nuk përjashtohet aktivizimi i të tjerëve apo lidhjeve të tyre në diasporë dhe në rajon.

Gjendja e familjarëve të LHT-ve paraqitet e rënduar. Mes tyre ka kërkesa për riatdhesime në vendet e origjinës. Shumica ndodhet në kampet në Siri, në kushte të vështira, dhe kërkojnë nga familjarët e tyre ndihma financiare dhe gjetjen e rrugëve për

kthim në vendet e origjinës. Kosova është ndër vendet e para të rajonit që realizoi riatdhesimin e një numri familjarësh, shumica gra dhe fëmijë, që po trajtohen rast pas rasti dhe u janë nënshtruar programeve deradikalizuese e riintegruese. Vende të tjera po shohin mundësitë e riatdhesimit të të kapurve në kampet kurde dhe trajtimit të tyre rast pas rasti sipas legjislacionit.

Kthimi i gjithë familjarëve të LHT-ve në vendet e rajonit do të kërkojë angazhime konkrete në programe specifike deradikalizimi dhe riintegrimi. Përcaktimet ligjore mundësojnë trajtimin e selektuar. Do të nevojitet balancim i masave shtrënguese me ato rehabilituese e riintegruese. Vëmendja duhet drejtuar te numri i lartë i fëmijëve, me projekte të veçanta dhe afatgjata për deradikalizimin, integrimin, edukimin me asistencë psikologjike, për të mos u përballur me një gjeneratë të re kontingjent kërcërimi.

Trajtimi i problematikave që lidhen me këtë kategori kërkon një qasje gjithëpërfshirëse aktorësh shtetërorë dhe joshtetërorë.





RADIKALIZIMI DREJT EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Komunitetet zyrtare islame në rajon dhe vendin tonë e kanë dënuar hapur dhunën dhe ekstremizmin në emër të besimit fetar, por vlerësojmë se duhet të bëjnë më shumë në kundërvënien ndaj narrativës së ekstremizmit e terrorizmit, si dhe të edukimit të klerikëve të linjës zyrtare që përfaqësojnë.


Përfaqësues e mbështetës të linjave e shkollave radikale, kryesisht nga vende arabe, përpiqen të ndërhyjnë dhe ndikojnë nën mbulesë fetare e humanitare mbi komuniteteve fetare, duke shfrytëzuar nevojat financiare të tyre.

Disa organizata në rajon, të përfshira në aktivitete radikalizmi, janë mbyllur ose pezulluar.

Numri i ambienteve private të përdorura si objekte kulti jashtë juridiksionit të komuniteteve fetare, është reduktuar falë masave nga qeveritë dhe komunitetet zyrtare fetare. Implementimi i strategjive kundër ekstremizmit të dhunshëm, mekanizmat e krijuara në zbatim të Planit të Masave referuar këtyre strategjive kanë filluar të japin efektet parandaluese.

Të dënuarit për terrorizëm vijojnë të mbajnë profil të lartë dhe me tendenca aktivitetesh radikalizuese ndaj të burgosurve të tjerë. Radikalizimi në burgje mbetet fenomen shqetësues e sfidë afatgjatë, duke mbajtur parasysh kthime të mundshme të LHT-ve dhe të familjarëve.

Profili i përgjithshëm i aktorëve me synime terroriste



MODUS OPERANDI E ORGANIZATAVE TERRORISTE

Nga karakteristikat e evidentuara në synimet apo planet për akte terroriste në rajon dhe vendin tonë, veçojmë:

1. Thirrje, nxitje, koordinim nga LHT në terren të lidhjeve të tyre të vjetra në vendin e origjinës.

2. Aktivizim i ish-LHT të kthyer, kryesisht nga radhët e atyre që vijnë të mbajnë profil radikal e vijnë të jenë ndjekës të propagandës e ideologjisë ekstremiste.

3. Aktivizim për mbështetje logjistike të individëve me sfond radikal mbështetës të linjave ekstremiste që deklarojnë ose pretendojnë përkatësi fetare.

4. Udhëzime në rrjetet sociale të komunikimit të sigurt dhe aktivizim online të disa elementëve të nivelit të dytë për nga rrezikshmëria, duke shfrytëzuar mbështetës të ideologjive ekstremiste fetare.

5. Synime/plane për kryerjen e sulmeve përveç shtetit të origjinës, edhe në një shtet tjetër kufitar.



EMIGRACIONI I JASHTËLIGJSHËM

Ruga ballkanike vijon të mbetet linjë rëndësishme për emigracionin ilegal që shkon drejt Evropës. Në këtë kuadër, Shqipëria vijon të mbetet vend tranzit për kalimin e emigrantëve të paligjshëm. Fluksi i emigrantëve të paligjshëm që kanë hyrë nëpërmjet kufirit të gjelbër, në jug dhe juglindje të Shqipërisë, ka shënuar rritje.

Rrjete të trafikut njerëzor po përdorin këtë kontingjent për kalime të paligjshme kundrejt përfitimeve financiare, nga kufiri i gjelbër përgjatë lëvizjes në vende të ndryshme, duke iu mundësuar pajisjen me dokumente false, lehtësi dhe udhëzime për itinerarin.

Vërehet rritje e rasteve të organizimit të emigracionit të paligjshëm nga persona e grupe, që orientojnë emigrantët e paligjshëm nga llogari të ndryshme në rrjetet sociale kundrejt pagesës. Ka të dhëna për favorizim të emigracionit të paligjshëm nga organizata të deklaruar si humanitare, të cilat organizojnë trafikun e klandestinëve nga Turqia drejt Greqisë, Shqipërisë dhe më

pas drejt Evropës Perëndimore.

Masat e përforcuara të sigurisë kufitare, bashkëpunimi i suksesshëm me Frontex, kanë lehtësuar monitorimin e fluksit të emigracionit të jashtëligjshëm.

Vlerësojmë se, nuk përjashtohet mundësia e shfrytëzimit të kësaj rruge, me dokumente false të siguruar nga krimi i

organizuar, për infiltrim operativësh terroristë me synim kalim transit drejt vendeve perëndimore dhe testim të përdorimit të kësaj rruge nga terroristët.

Në një rast, një ish-operativ terrorist i kërkuar nga INTERPOL, u ndalua për hyrje të paligjshme në vendin tonë përmes kufirit të gjelbër me Greqinë. Pavarësisht identiteteve



të shumta të përdorura nga operativi, agjencitë ligjzbatuese shqiptare, në bashkëpunim me partnerë rajonalë dhe evropianë, arritën ta identifikonin dhe ndalonin. Ndalmimi prej agjencive ligjzbatuese u pasua nga procedurat e ekstradimit.

Një përpjekje e pasuksesshme (rasti i terroristit rus)

SHISH-i ka vijuar punën për monitorimin e fluksit të emigracionit të jashtëligjshëm. Qëllimi është shmangia e rasteve kur ky fluks mund të përdoret për hyrje apo për kalim tranzit në vendin tonë drejt vendeve evropiane të operativëve terroristë. Në këtë kuadër, u finalizua me sukses identifikimi i një shtetasi rus, i kërkuar për terrorizëm, dhe arrestimi i tij në korrik 2019.

Identifikimi dhe arrestimi ishte rrjedhim i një bashkëpunimi intensiv mes SHISH dhe DPPSH. SHISH-i bashkëpunoi me partnerët për verifikimet të dhënave të dyshimta të cilat, pas analizës rezultuan treguan se individi i hyrë në Shqipëri si refugjat i paligjshëm, rezultoi të ishte operativ i organizatës terroriste Shteti Islamik, i kërkuar nga Interpoli.

Terroristi Resul Visanievich Mislav (Rasoul Visanievitch MISLAEV), i arrestuar në korrik 2019, njëhej

edhe me emrat si Abd Al-salam Ahmed Al MOUSA, i thirrur ndryshe edhe Diego.

Ai u ndalua së pari nga autoritetet policore kufitare në korrik 2018 dhe u intervistua prej tyre. Gjatë intervistës, deklaroi se e quanin Diego dhe tha se donte të udhëtonte për në Itali, ku kishte edhe bashkëshorten. Komunikoi deri në momentin kur, gjatë intervistës, është pyetur në gjuhën arabe. Pas kësaj ndërpreu çdo lloj komunikimi. Për shkak të plagëve të konstatuara gjatë kontrollit në trup, ai u veçua si person me risk mes emigrantëve të paligjshëm nga vendet MENA.

SHISH-i u koordinua me një sërë shërbimesh partnere strategjike dhe evropiane, për identifikimin të këtij personi, të dyshuar si LHT. SHISH-i kërkoi vendosjen në “watch list” të personit me gjurmët e gishtave dhe gjeneralitetet

në dispozicion.

Nisur nga dyshimet e krijuara, nga vetë informacionet që kishte mbledhur SHISH, nga materialet e përfutuara nga intervistimet, Drejtoria e Antiterrorit e Policisë Shqiptare ia referoi rastin Prokurorisë për Krimet e Rënda në Tiranë, me arsyetimin se ky shtetas i huaj dyshohej se kishte luftuar me grupet terroriste në zonat e përfshira në konflikte të armatosura Siri/Irak, vepër e dënueshme sipas kodit tonë penal. Personi u ekstradua sipas procedurave ndërkombëtare në fuqi.

Vlerësojmë se arrestimi i një operativi të ISIL/DAESH, hyrë nëpërmjet emigracionit të paligjshëm, nga kufiri i gjelbër me Greqinë, shënon rastin e parë të përdorimit të kësaj rruge në vendin tonë. Identifikimi i tij si person i dyshimtë dhe verifikimet në vijimësi për gjeneralitetet e shumëfishta, janë rezultat i punës së kujdesshme parandaluese e

NJË TIPOLOGJI PËRDORIMI E RRUGËS

1 Paraqitje si refugjat nga Siria dhe kalim i paligjshëm nëpërmjet trafikut njerëzor nga Turqia drejt ishujve grekë.

2 Hyrje nga pika të kufirit të gjelbër me identitete false.

3 Evitim i regjistrimit në kampet e refugjatëve përgjatë itinerarit të lëvizjes.

monitoruese, bashkëpunimit të vijueshëm si brenda vendit dhe me shërbimet partnere. Arrestimi i tij në vendin tonë dhe bërja publike ndihmon

si masë parandaluese dhe mesazh organizatave terroriste se Shqipëria nuk është vend i sigurt për terroristët, por edhe mesazh paranda-

lues në ndihmë të vendeve të tjera se rruga e emigracionit të paligjshëm dhe fluksi i refugjatëve mund të përdoren nga organizata terroriste.



Diego është identifikuar si Abd Alsalam Ahmed Al MOUSA, lindur më 1979 në Homs, Siri. Abd Alsalam Ahmed Al MOUSA hyri në Shqipëri nga kufiri i gjelbër me Greqinë. U deklaroi forcave policore se quhej “Diego” dhe ishte nga Siria, se dëshironte të shkonte në Itali, pasi atje kishte bashkëshorten dhe një fëmijë të vogël që e prisnin. Fillimisht foli në disa gjuhë të huaja si anglisht, rusisht, italisht dhe arabisht. Punonjës të SHISH-it në intervistimet së bashku me

Kush është Diego?

DPPSH janë përgjigjur në arabisht por, nga ky çast, personi ndërpreu komunikimin. Në kontrollin fizik iu konstatuan në trup shenja e plagë të marra nga predha, armë zjarri dhe mjete prerëse. Pasi u soll në ambientet e Qendrës së Mbyllur të Refugjatëve në Tiranë, deklaroi se quhej Diego Darvish, i biri i Adam dhe i Hava, i datëlindjes 15.05.1993, me shtetësi siriane. Gjatë një intervistimi pas disa javësh, deklaroi se e quanin Abdurahman Darvish. Gjatë periudhës së qëndrimit në ambientet e mbyllura, u përpoq të krijonte shoqëri me shtetas të huaj kryesisht nga vende si Siria, Iraku, Irani, Pakistani, Maroku Algjeria, etj. Lidhur me shenjat në trup, shprehej se i kishte



bërë vetë gjatë qëndrimit në kampet në Turqi, në shenjë revolte ndaj mosplotësimit të kushteve. Thoshte se nuk kishte motra e vëllezër dhe prindërit i kishin vdekur. Gjatë qëndrimit në qendrën e izolimit kryente rregullisht ritet fetare islamike, si dhe kujdesej për gjendjen fizike duke kryer vazhdimisht ushtrime gjimnastikore. Nga verifikimet intensive të kryera, rezultoi se i ashtuquajhuri Diego është terroristi Rasul Visanievitch MISLAEV, lindur në Norilsk (Federata Ruse).

MIGRATORE NGA OPERATIVË TERRORISTË

Përdorim i dokumenteve false, identiteteve të shumfishta.

4

Ndryshim i pamjes së jashtme.

5

Manipulim i lëvizjes dhe shprehje e pakënaqësisë nga trajtimi në kampet e refugjatëve sirianë në Turqi.

6

AKTIVITETI I SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS ME QËNDRIM JOMIQËSOR

Shërbimet e inteligjencës së shteteve kundërshtarë të aleancës euroatlantike, proceseve euro-integruese të rajonit dhe vendit tonë, vijojnë aktivitetin e tyre konstant dhe me tendenca rritje në momente zhvillimesh të rëndësishme që lidhen me proceset integruese

por edhe me problematika ndërshtetërore të bartura. Përveç metodave klasike të grumbullimit të inteligjencës, nëpërmjet angazhimit të personelit të shërbimeve të sigurisë dhe inteligjencës, vërehen tendenca rritjeje dhe ndërthurja e metodave klasike me ato hibride.

ÇFARË JANË AKTIVITETET HIBRIDE

Aktivitetet hibride në tërësinë e tyre janë një kombinim i metodave të mbyllura me ato të hapura, konvencionale me ato jo konvencionale dhe përfshijnë dezinformim, propagandë, sulme kibernetike, grumbullim informacioni sensitiv nëpërmjet ndërhyrjes/aksesit në rrjete kompjuterike në format e spiunazhit kibernetik, aktivitete/operacione influencuese informative dhe psikologjike, presion ekonomik. Metodot hibride po zbehin kufijtë mes paqes dhe luftës, shpejtësia, shkalla dhe intensiteti i tyre kanë njohur rritje vitet e fundit. Këto aktivitete po përdoren jo vetëm nga aktorë shtetërorë por edhe nga aktorë jo-shtetërorë që veprojnë si të tretë, për përfitime financiare, me aktivitete të koordinuar apo kryer për llogari të shteteve/shërbimeve të tyre të inteligjencës. Mënyrat e angazhimit variojnë për nga shkalla e përfshirjes, kompleksitetit dhe sofistikimit.

Aktivitetet e natyrës hibride përdoren për synime të caktuara politike/gjeopolitike e gjeoekonomike dhe kanë si objekt kryesor të shkaktojnë destabilitet në një shtet kundërshtar, varësi politike dhe ekonomike. Kërcënimet e natyrës hibride kanë marrë një dimension tjetër që, për nga shkalla, po zëvendësojnë metodat klasike të grumbullimit të inteligjencës, favorizuar nga zhvillimi i teknologjisë së informacionit, koston më të ulët në krahasim me angazhimin agjentësh inteligjence, mundësisë së shpërndarjes për një publik më të gjerë dhe

impaktit më të madh.

Shtetet kundërshtarë/shërbimet e tyre të inteligjencës identifikojnë dobësitë në fushën diplomatike, politike, sociale, ekonomike, financiare, ushtarake, inteligjencës dhe në infrastrukturën e vendit kundërshtar dhe në përputhje me këto, përgatisin planet për implementimin e aktiviteteve hibride, bazuar në situatën specifike sociale, ekonomike dhe politike të një vendi të caktuar. Aktivitetet e hapura influencuese mund të jenë operacione informative që lidhen me propagandën, dezinformacionin dhe në përgjithësi me ndikimin e publikut në shtetet me interes.

Një rajon i pastabilizuar e në cikle krizash, në momente zhvillimesh specifike integruese u shkon për shtat synimeve të dëshiruara të shteteve kundërshtarë. Aktorë gjeopolitikë kundërshtarë të proceseve integruese të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve influencuese synojnë edhe amplifikimin e problematikave aktuale për ta paraqitur rajonin tonë si të padëshirueshëm për perëndimin, me kapacitete kërcënuese për stabilitetin evropian dhe njëkohësisht targetojnë organizmat ndërkombëtarë si të dështuara në politikat përkundrejt rajonit.

Pas çdo zhvillimi të rëndësishëm ka një narrativë/qasje të shteteve kundërshtarë si pjesë e synimeve strategjike, në deklarata të hapura publike dhe në formën e publikimeve në media të caktuara, ripublikimeve nga të tretë, aktivitet që vlerësohet të vijojë në mënyrë progresive.

Këtu ndikon edhe dukuria e lajmeve të rreme, që po përdoret gjerësisht për synime influencuese. Kanale mediatike të shkruara dhe online, media sociale po përdoren edhe për shtrembërimin dhe manipulimin e realitetit nëpërmjet mohimit, mashtrimit dhe dezinformimit, me synime të caktuara. Objektivi është të ndikojnë mbi opinionin publik, të dëmtojnë kohezionin social, përçajnë vendimmarrjet kombëtare dhe ato ndërkombëtare në raport me zhvillime të qenësishme, shenjestrojnë e denigrojnë aktorë e faktorë ndërkombëtarë në raport me qëndrimet/rekomandimet e tyre ndaj vendeve të rajonit përfshi vendin tonë.

Përveç prezencës konstante me format klasike të spiunazhit, rekrutimeve dhe qasjeve ndaj entiteteve e individëve me akses në informacione të klasifikuara dhe sensitive, kjo

qasje hibride përfshin edhe mjete të tjera të influencës si lëvizje e parti politike me agjenda nacionaliste e etnike, drejtues të veçantë të tyre, OJQ kulturore, arsimore, shoqata miqësie, grupe biznesi, komunitete fetare, media të caktuara dhe portale mediatike online, institute studimore, grupe e klube tifozerie, etj.

Përpjekjet për investime në sektorë strategjikë të ekonomisë në rajon, synojnë objektiva afatgjatë gjeoekonomike dhe rritje të ndërvartësisë ekonomike, që do sillnin edhe modulime të politikave.

Në këtë kuadër, edhe vendi ynë nuk është i përjashtuar. Orientimi i qartë perëndimor dhe euro-atlantik i Shqipërisë, performanca dhe roli si faktor stabiliteti në rajon, do vijojë të jetë në fokusin e aktiviteteve të shërbimeve të inteligjencës kundërshtarë dhe aktiviteteve hibride të shteteve që përfaqësojnë.

Elona - inspektore

Unë jam Elona. Kur studioja për shkencë sociale, dëshiroja të aktivizohesha me shoqërinë civile për çështje të drejtave të grave dhe vajzave, veçanërisht për mbrojtjen e grave të dhunuara e trafikuar. Pas diplomimit, fillova punë në SHISH. Puna në këtë institucion, më bëri të kontribuoj për këtë çështje në një mënyrë krejt tjetër nga sa e kisha menduar. Duke punuar si inspektore terreni për çështje kundër krimit të organizuar, kundër trafikut të drogës dhe të qenieve njerëzore, jap kontributin tim kundër kësaj dukurie negative që, për fat të keq, shfrytëzon edhe gra e vajza në trafikun e drogës, apo i trafikun ato për motive prostitucioni. Ndër vite jam rritur profesionalisht dhe jam krenare që mund të bëj diçka për vënien para përgjegjësisë ligjore të individëve e grupeve kriminale të përfshira në këtë aktivitet. Shpesh më ndodh të jem pjesë e operacioneve që i kam lexuar dikur në librat e spiunazhit. Ato ndodhin vërtet në jetën tonë, madje në mënyra edhe më të vështira, pa nuancat artistike që u japin shkrimtarët personazheve të tyre. Kur e tregon, mund të tingëllojë si aventurë tërheqëse, por është krejt ndryshe nuk e përjeton. Krahas frikës dhe emocioneve, mbizotëron përgjegjësia e realizimit të detyrës. Shpesh, pasi ke realizuar një mision të tillë, dëshiron të vraposh në shtëpi e t'ia tregosh një njeriu të afërt atë që ke përjetuar. Por duhet thjesht të vijosh rutinën, e qetë, sikur nuk ka ndodhur asgjë. Është diçka që bën të ndihesh me vlera, por e heshtur, anonime. Siguria e burimeve të informacionit është në duart e mia dhe kurrsesi nuk mund të vë në rrezik gratë e vajzat që kanë zgjedhur të luftojnë kundër shfrytëzimit të tyre. Ndjem e plotësuar në lidhje me ëndrrën studentore, sepse kontributi im është konkret. Sfidë që kam zgjedhur më bën të ndjem e plotësuar.




PRODUKTI INFORMATIV

Në përgatitjen e produktit informativ, SHISH-i ka mbajtur parasysh si parametra kryesore cilësinë, objektivitetin, vijueshmërinë dhe dobinë.

Gjatë 2019-ës, ka vijuar me ritëm dinamik informimi i autoriteteve kryesore si President, Kryeministër, MEPJ, MPB e ministri të tjera. Është intensifikuar bashkëpunimi me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese si DPPSH, Prokurorinë e Përgjithshme dhe të Krimeve të Rënda, DPPP, etj. Po ashtu, edhe bashkëpunimi me SHIVH partnere.

SHISH-i ka prodhuar për vitin 2019, 4087 informacione për klientët brenda dhe jashtë vendit.


Krahasuar me vitin 2018, ka 486 produkte informative më shumë, ose rreth 13% më shumë.



Produkti informativ i SHISH-it ndër vite

Produkti informativ i SHISH-it në 2019


Duke qenë se dukuritë dhe veprimtaria antiligjore, tashmë zhvillohen në rrafsh më të gjerë rajonal e ndërkombëtar, është shtuar dhe Produktit Informativ i destinuar për SHIHV, duke zënë peshën kryesore me 2366 informacione, ose 58% të informacionit, ndërsa ai për klientët brenda vendit është 1721 informacione, ose 42% të totalit.




Ndarja e produktit informativ
■ Brenda vendit dhe ■ Jashtë vendit

Peshën kryesore në Produktin Informativ të destinuar për klientët brenda vendit e zë informimi në nivel qendror me 1090 informacione, i cili përbën 63% të totalit, ndërsa ndarjet në nivel vendor me 631 informacione, ose 37% të totalit.

Për klientët brenda vendit, produkti informativ i SHISH-it ka shërbyer për informimin e institucioneve të larta të shtetit, Presidentin e Republikës, me 248 informacione, kundrejt 243 në total gjatë vitit 2018; Kryeministrin e Shqipërisë, me 290 informacione kundrejt 278 informacione në total gjatë vitit 2018; Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme me 137 informacione, kundrejt 154 në 2018-ën, Ministrinë e Brendshme me 108 informacione, kundrejt 80 informacione në total në 2018. Gjithashtu, MM 15 informacione, MD 18 informacione, MIE 17 informacione, DATAK 28 informacione si dhe ministrinë e tjera të linjës sipas specifikës.



Produkti informativ për institucionet e larta shtetërore 2019



Produkti informativ 2019 për Prokurorinë, për DPPSH-në dhe agjenci të tjera ligjzbatuese

Vijon trendi pozitiv i informimit për autoritetet e larta shtetërore dhe në nivel qendror të agjencive ligjzbatuese.

Me klientët në fushën e hetimit dhe të zbatimit të ligjit, SHISH-i ka vijuar me kontribute në bashkëpunimin me Prokurorinë dhe Policinë e Shtetit, DPPPP si dhe institucionet e tjera. Produkti informativ për Prokurorinë është gjithsej 312 informacione, ku peshën kryesore e zë Prokuroria e Krimeve të Rënda (PKR) me 184 informacione, PP me 76 informacione, PRRGJ-të me 52 informacione; DPPSH me 431 informacione kundrejt 346 gjatë vitit 2018, DVP-të me 597 informacione, kundrejt 325 në vitin 2018, DPPPP me 50 informacione, si dhe institucione të tjera.

ZHVILLIMET IT&T DHE DIGJITALIZIMI



Evoluimi i mëtejshëm i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe telekomunikimit (IT&T) dhe mundësitë e ofruara nga shfrytëzimit i hapësirës kibernetike gjatë vitit 2019, ka sjellë nevojën për qasjen dhe shfrytëzimin gjithmonë e më të madh të këtyre mundësive dhe teknikave nga ana e institucionit. Për të qenë në hap me këto zhvillime, SHISH-i ka vijuar zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve IT&T, qoftë në pikëpamjen infrastrukturore, të burimeve njerëzore, ashtu edhe në aspektin procedural e normativ.

Gjatë 2019-ës, SHISH-i vijoi me një digjitalizim të disa proceseve të punës, duke sjellë lehtësira për punonjësit dhe rritur ndjeshëm shpejtësinë e ndërveprimit midis hallkave që janë pjesë e proceseve. Digjitalizimi është proces i gjatë dhe i vështirë për t'u aplikuar, si në aspektin teknik ashtu edhe në atë normativ. Përparimi i ndjeshëm i arritur gjatë 2019-ës në këtë drejtim, na detyron dhe motivon të vijojmë më tej dhe me hapa të shpejtë e të sigurt me këtë proces të rëndësishëm të shekullit ku jetojmë.

Gjatë vitit 2019, SHISH-i vijoi me përmirësimin e infrastrukturës IT&T, duke mbajtur hapin e zhvillimeve bashkëkohore të infrastrukturave IT&T dhe duke ruajtur një balancë të arsyeshme mes aplikimit të zhvillimeve të reja dhe praktikave më të mira në këtë fushë, duke i dhënë rëndësi të veçantë aspekteve të sigurisë kibernetike. Gjatë vitit 2019, SHISH-i

ka aplikuar metodave dhe teknologji të reja në mbrojtjen e perimetrave dhe parandalimin e çdo situatë katastrofike nga sulmet kibernetike.

Në 2019, krahasuar me vitin 2018, u vu re aktivitet i shtuar keqdashës dhe kërcënues drejtuar infrastrukturës publike të SHISH-it. Me qëllim evidentimin e kërcënimeve dhe korrelimin e aktorëve dhe faktorëve keqdashës/kërcënues, SHISH-i ka zhvilluar më tej kapacitetet në pikëpamjen e analizimit dhe inteligjencës së kërcënimeve kibernetike, duke aplikuar sisteme dhe platforma me burim të hapur të modifikuara përshtatshëm.

Gjatë vitit 2019, SHISH-i ka vijuar më tej me zhvillimin e burimeve njerëzore, ku është arritur një nivel i kënaqshëm i përshtatjes në kohë dhe cilësi me ndryshimet teknologjike, ku vlen të theksohet kapaciteti i implementimit, administrimit dhe zhvillimit të platformave "Private Cloud", duke reduktuar kostot në investim, mirëmbajtje dhe konsulencë për infrastrukturën IT&T dhe mbrojtjen e saj.

Zhvillimet in-house, përdorimi/modifikimi i softuerëve me burim të hapur si dhe aplikimi rigoroz i politikave dhe procedurave të sigurisë në lidhje me infrastrukturën IT&T kanë qenë në fokus edhe gjatë vitit 2019. Ekipi IT&T në SHISH vijon vetëzhvillimin profesional në mënyrë që të jetë i përditësuar dhe të mbajë ritmin e risive teknologjike dhe aplikimit të tyre në mënyrë të arsyeshme.

LAJMI I RREMË DHE KËRCËNIMI PËR SIGURINË KOMBËTARE



Dukuria e lajmit të rremë po shihet sot në botë si një kërcënim serioz ndaj demokracisë. Krijimi dhe përhapja e lajmeve të rreme ka nxitur tension mes njerëzve e grupeve, manipulim fushatash politike, përhapje të propagandës së grupeve radikale e terroriste apo ndihmë të tërthortë për individë dhe grupe kriminale. Lajmi i rremë mund të çojë në kaos, panik, akte terrori, dhunë dhe lloje të tjera reagimesh që dëmtojnë individin, shoqërinë dhe institucionet shtetërore. Të gjitha këto, janë arsye të vlefshme për të bërë rregullime të nevojshme në mediat sociale.

Pak historik

Përpara hyrjes në masë të internetit, ka qenë më e vështirë, më e ngadaltë dhe më e kushtueshme të përhapje informacion të rremë, sepse mediat tradicionale kanë qenë më të rregulluara nga ligji dhe tregu. Por shfaqja e mediave sociale i prishi kufijtë që mbanin nën fre lajmet e rreme, duke i lejuar cilitdo të prodhojë, shkëmbejë dhe shpërndajë informacion. Në thelb, u larguan pengesat për lajmet e rreme.

Çfarë mund të quhet lajm i rremë?

Problemi i përkufizimit është se lajmi i rremë mund të marrë shumë forma, të prodhohet nga shumë autorë, të ketë arsye nga më të ndryshmet. Llojet më të përhapura të lajmeve të rreme janë:

- ato me përmbajtje sensacionale, të prirura nga gënjehuri i trafikut në rrjet për arsye tregtare
- ato me motive ideologjike, me synim ndikimin mbi njerëzit
- ato që kategorizohen si keqinformime shtetërore, me informacione të përziera, të vërteta dhe të rreme

Përkufizim

Lajm i rremë qubet një histori a lajm i pavërtetë, shpesh me natyrë sensacionale, i krijuar për t'u dukur si raportim i vërtetë gazetaresk, për t'u përhapur gjerësisht me media tradicionale (gazetë, televizion, radio) ose nga mediat sociale në Internet, me qëllim: gjenerimin e të ardhurave nga trafiku në rrjet, diskreditimin e figurave publike, lëvizjeve politike, kompanive, etj., ndikimin mbi opinionin publik mbi çështje të caktuara.

Tiparet e lajmit të rremë

Lajmi i rremë synon të prekë zemrat dhe mendjet e lexuesve, të kryejë një shpëlarje të tërthortë truri mbi individë dhe grupime, duke i bërë të besojnë diçka që nuk është e vërtetë. Lajmi i rremë zakonisht shkruhet me fjalë superlative dhe sensacionale, për të nxitur përgjigje emocionale nga lexuesi, një formë manipulimi kjo që ka infiltruar në mediat sociale aq gjerësisht dhe aq shpejt sa që e kanë bërë të vështirë edhe punën e specialistëve për të identifikuar burimet e besueshme të lajmeve nga ato që përhapin lajme të rreme.

Tipar tjetër është se këto lajme të rreme krijohen nga faqe të errëta, për t'u përhapur më pas nga mediat sociale nga mbështetës të vetëdijshëm të këtyre lajmeve apo nga lexues të pafajshëm që nuk mund ta dallojnë nga lajmet e vërteta. Janë krijuar platforma specifike që përdoren për të shënjestruar rajone të caktuara gjeografike, përkatësi fetare, gjinore, arsimore dhe socio-ekonomike, me mesazhe që depërtojnë deri te publiku i dëshiruar.

Mjetet më të përdorshme për përhapjen e tyre janë:

- mediat sociale, që funksionojnë me tekst, fotografi dhe pamje video dhe nëpërmjet një numri të lartë ndjekësish
- faqet e ashtuquajtura “guerile” të lajmeve, që përziejnë faktet, opinionet dhe sajimet e pastra, në mbështetje të partive, pozicioneve, alternativave, doktrinave apo individëve të caktuar
- faqet e ashtuquajtura “parodi”, që imitojnë faqe të njohura mediatike



Si cenohet siguria nga lajmet e rreme?

Kriminelët e hapësirës kibernetike e shfrytëzojnë këtë fushë të gjerë mundësish jo vetëm për ta shndërruar në biznes fitimprurës përhapjen e lajmit të rremë. Lajmet e rreme të përhapura nga entitete shtetërore mund të cenojnë sigurinë kombëtare të shteteve të tjera duke ndikuar në opinionin e gjerë publik atje, apo mbi vendimmarrjen e institucioneve. Kështu, problem tashmë i identifikuar në botë është përdorimi i lajmeve të rreme në fushata zgjedhore nga aktorë brenda apo jashtë vendit. Kurse në vendin tonë janë vërejtur përhapje lajmesh të rreme më tepër për qëllime përfitimi financiar apo kredoje politike e sociale.

Çfarë bën SHISH-i kundër kësaj dukurie?

Qeveritë, kompanitë, përdoruesit po zgjohen lidhur me atë se sa serioz është sot manipulimi i opinionit, i shfaqur në formën e lajmit të rremë.

Edhe qeveria shqiptare ka nisur ta pohojë faktin që lajmi i rremë është diçka që duhet luftuar aktivisht. Këtij qëndrimi i janë bashkuar edhe institucione dhe agjenci të ndryshme qeveritare, të cilat po punojnë për vendosjen e rregullave mbi përhapësit e informacionit dhe ndëshkimin e përhapësve të lajmeve të rreme. Edhe SHISH-i po punon në këtë drejtim.

SHISH-i mbledh informacion edhe nga burimet e hapura, çka do të thotë se ndeshet përditë me informacione

të rreme që kanë depërtuar në këto burime. Sfida që paraqesin lajmet e rreme për analistët e inteligjencës është, në fakt, procesi i dallimit të lajmit të rremë nga lajmi që vjen prej burimeve të besueshme, në përpjekje për të nxjerrë informacione cilësore nga kanalet e burimeve të hapura. Vështirësia qëndron te identifikimi, analizimi dhe pengimi i përhapjes së lajmit të rremë, për të parandaluar ndikime të padëshirueshme apo të dëmshme mbi sigurinë kombëtare. Njësitë tona të specializuara për burimet e hapura përditësojnë vazhdimisht njohuritë, duke identifikuar faqe sociale dhe portale që e përdorin më së shumti prodhimin dhe përhapjen e lajmit të rremë për qëllime të pandershme fitimprurëse apo ndikimi politik dhe duke kuptuar mekanizmat e funksionimit të kësaj dukurie.

Dallimi mes lajmit të vërtetë dhe atij të rremë nuk është gjithmonë aq i lehtë. Për këtë arsye, punonjësit në SHISH dhe kandidatët për punonjës, iu nënshtruan në 2019 një trajnimi të posaçëm kushtuar lajmit të rremë, rrezikut të tij dhe mënyrave për ta identifikuar e penguar përhapjen e tij. Puna e SHISH-it kundër lajmeve të rreme, ndjek masat e ndërmarra nga shërbimet partnere të vendeve të NATO-s dhe BE-së, të cilët punojnë për të dhënë sinjale të qarta paralajmëruese në betejën për dallimin mes së vërtetës dhe së rremes, sipas ligjit dhe parimeve kushtetuese dhe nevojën për balancë mes dy interesave në përplasje: nevojës për të shmangur efektet e padëshirueshme të kësaj dukurie, në dobi të procesit të vendimmarrjes dhe procesit demokratik, dhe nevojës për ruajtjen e vlerave demokratike.



PYETJE DHE PËRGJIGJE RRETH LAJMIT TË RREMË

Çfarë është lajmi i rremë?

Lajmi i rremë është dezinformim, keqinformim dhe propagandë. Është me rëndësi të bëjmë dallimin mes informacionit të gabuar, satirik apo lajmeve jo tërësisht të vërteta dhe informacionit të vërtetë, por që cilësohet si i rremë me qëllim që njerëzit të mos e besojnë.

Pse i përhapin njerëzit lajmet e rreme në mediat sociale?

Studime të ndryshme synojnë të vlerësojnë se si ekspozohen njerëzit çdo ditë ndaj lajmeve të rreme dhe të kuptojnë sa njerëz ka të ngjarë ta besojnë si të vërtetë një informacion të rremë, duke qenë kështu edhe shpërndarës të mundshëm të tij. Studimet tregojnë se, ekspozimi për një kohë të gjatë ndaj lajmeve të rreme, ul rezistencën e personit dhe e bën më të prirur për të shpërndarë informacion të pavërtetuar, sidomos kur ky vjen nga burime me ndikim.

Cilët janë tre shpërndarësit më të shpejtë?

1. Trollët - Trollët janë njerëz që shpërndajnë lajme të pavërteta provokuese dhe emocionale. Zakonisht mbështesin lajmet e rreme në vijë me ideologjinë e tyre, duke gjeneruar komente e fyerje ose duke trembur përdoruesit dhe figurat publike apo duke minuar besueshmërinë e ideve që nuk u pëlqejnë. Krijojnë llogari të shumta në rrjetet sociale, vendosin aty emra, fotografi dhe përshkrime të rreme të vetes, mbledhin miq dhe ndjekës, pastaj fillojnë të mbështesin lajme të rreme ose të krijojnë dhe shpërndajnë vetë lajme të rreme. Trollët mund të jenë të mirë për të ndikuar mbi grupe njerëzish që janë më pak të bindur dhe kërkojnë informacion për tema të veçanta.

2. Robotët - Robotët janë algoritme kompjuterike që simulojnë sjelljen e qenieve njerëzore në rrjetet sociale dhe janë të mirë për të shpërndarë sasi të mëdha mesazhesh emocionale me pak informacion në përmbajtje. Këto mesazhe përhapen më pas nga ata që janë në të njëjtën linjë me përmbajtjen bazë të tyre. Robotët përhapin lajme të rreme mes njerëzve të a nshëm. Platformat e mediave sociale (Facebook, Twitter, Instagram, etj.) janë kthyer në vatra të miliona robotëve socialë që shpërndajnë lajme të rreme. Në 2017-ën, në Twitter kishte 23 milionë robotë (rreth 8,5% e gjithë llogarive), në Facebook kishte 140 milionë të tillë (rreth 5,5 % e llogarive) dhe në Instagram 27 milionë (8,2% e llogarive). Pra, 190 milionë robotë në vetëm tri platforma mediash sociale!


3. Ligji i fuqisë - I ashtuquajtur "ligji i fuqisë" në mediat sociale thotë se, mesazhet përhapen më shpejt nëse ato dërgohen fillimisht te një numër i vogël njerëzish me ndikim, por me shumë ndjekës.

Cilët njerëz shënjestrohen nga lajmet e rreme?

Provat tregojnë se të rinjtë, të moshuarit dhe ata me nivel të ulët arsimor janë më të prirur të jenë viktimat e para të lajmeve të rreme. Pasojnë fanatikët partiakë dhe çdo lloj ekstremistësh, sepse kanë prirje të besojnë lajme që mbështesin bindjet e tyre.

A mund t'i luftojmë lajmet e rreme?

Dezinformimi do të jetë gjithmonë i pranishëm. Por mund të ngadalësojmë dhe pengojmë përhapjen e tij me tri mjete kryesore.



1. Platformat e mediave sociale mund t'i dallojnë më shpejt lajmet me përmbajtje të pavërtetë dhe të vendosin paralajmërimet ose ta karantinojnë atë informacion.

2. Të jesh në gjendje të vlerësosh dhe ndash lajmet e rreme nga të vërtetat është pjesë e të pasurit të njohurive mediatike. Ka strategji që mund t'i përdorim të gjithë për të dalluar lajmin e rremë, sidomos në mediat sociale. Disa pyetje kyçe na ndihmojnë të kuptojmë më mirë para se të vendosim të shpërndajmë një lajm në mediat sociale:

Kush e krijoi këtë?

Pse e krijoi?

Kujt i drejtohet mesazhi?

Çfarë teknikash ka përdorur për ta bërë mesazhin të besueshëm?

Çfarë hollësish janë lënë jashtë dhe pse?


Si të bën të ndjehesh ky mesazh?

3. Për më tepër, rreziku i mediave sociale duhet analizuar si një menaxhim strategjik rrisht nga mediat, agjencitë qeveritare dhe sektori privat.

Në epokën e fushatave të dezinformimit, mashtrimeve imazherike dhe peshkimit të klikimeve, të jesh i aftë të identifikosh informacionin cilësor është bërë pjesë thelbësore e të qenit qytetar i përgjegjshëm.

Drini - Inspektor i burimeve të hapura dhe krimin kibernetik

Unë jam Drini. Pasi përfundova studimet e larta në fushën e Teknologjisë së Informacionit, fillova punë në një biznes privat që shiste pajisje kompjuterike. Por, me kalimin e viteve në të njëjtin pozicion pune, pavarësisht të ardhurave financiare, vura re se nuk po zhvillohesha dhe nuk po ecja përpara nga ana profesionale. Një ditë, takova një nga shokët e mi të fakultetit, i cili kishte filluar punë në strukturat e sigurisë, në fushën TI. Pas bisedave të përgjithshme dhe të punës, më pyeti: "Drini, a ke menduar të ndërrosh punë? Përse nuk aplikon në SHISH? Në faqen e tyre zyrtare ka një njoftim për vende të lira dhe kërkon specialistë me formim TI. Aty do të kesh mundësi të përditësosh njohuritë jo vetëm të fushës sonë, por edhe si specialist i kibernetikës." Për fushën spiunazhit klasik kisha lexuar shumë libra dhe parë shumë filma. Po zhvillimi i një beteje të tillë në hapësirën kibernetike ishte diçka e re që po më tërhiqte. Vendosa të aplikoja. Pas verifikimeve të procedurave të sigurisë, fillova punë në Shërbim. Në thelb, detyra jonë është të mbrojmë sistemet nga ndërhyrjet e paautorizuara, të kryejmë teste vulnerabiliteti, analizë rrisht dhe vlerësime për incidente të ndryshme në hapësirën kibernetike dhe online. Ka pasur dhe ka përpjekje për sulme, hakime, ndërhyrje, por ne jemi gjithmonë aty, pas perdes virtuale, të gatshëm të veprojmë dhe parandalojmë. Për të ecur me hapin e zhvillimeve të vrullshme të mediave online dhe të teknologjisë që përdoret nga rrjetet kriminale, ne ndjekim nga afër zhvillimet e fushës por jemi përfshirë edhe në trajnime të specializuara në vende partnere, njëkohësisht duke trajnuar edhe kolegët tanë. Po ashtu, filtrojmë dhe informacione nga burimet e hapura, duke pasur parasysh se sa hapësirë ka marrë sot dukuria e përhapjes së lajmeve të rreme në rrjetet sociale, duke ndikuar kështu në një analizë dhe vendimmarrje sa më të saktë për çështje delikate. Sot jam shumë i lumtur me zgjedhjen që kam bërë. Jam pjekur nga ana profesionale dhe i shërbej sigurisë së vendit.






BUXHETI DHE MENAXHIMI FINANCIAR I SHISH-IT

Shërbimi Informativ i Shtetit, gjatë vitit 2019, ka administruar një buxhet në shumën rreth 1,64 miliard lekë, nga 1,55 miliard vitin e shkuar. Nga kjo shumë, rreth 70% shkon për pagat dhe sigurimet e punonjësve dhe pjesa tjetër për investime dhe plotësim të nevojave të institucionit me mallra dhe shërbime.

Prokurimet për këto mallra dhe shërbime, për një pjesë të tyre, kryhen pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik ndërsa për blerje pajisjesh të Teknologjisë së Informacionit dërgohen pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Investimet kanë të bëjnë kryesisht me përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit dhe blerjen e pajisjeve bashkëkohore të teknikës operative.

Në fillim të këtij viti, Këshilli i Ministrave



miratoi me VKM nr. 259, datë 24.04.2019, rritjen e pagave për punonjësit e SHISH-it. Klasifikimi i pagave sipas nivelit dhe vështirësisë së punonjësve u krye duke respektuar efektet financiare vjetore të vendosura nga Ministria e Financave.

Gjatë vitit 2019, Shërbimi Informativ i Shtetit hartoi regjistrin dhe strategjinë e riskut, që vjen si kërkesë e Neneve 10 dhe 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Qëllimi i Strategjisë është të sigurojë që koncepti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të kulturës organizative, nëpërmjet filozofisë së zvogëlimit të riskut dhe vlerësimit të tij, për çdo veprimtari që kryen institucioni i Shërbimit Informativ i Shtetit. Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të riskut në Shërbimin Informativ të Shtetit, sipas një metode sistematike që përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e SHISH-it me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara në fushën financiare.

Si përfundim, gjatë vitit 2019, SHISH-i i ka menaxhuar fondet buxhetore me ekonomi dhe efikasitet.

Për vitin 2020, SHISH-it i është akorduar një fond në shumën 1,87 miliard lekë.



BURIMET NJERËZORE


Gjendja aktuale e Burimeve Njerëzore

Struktura e SHISH-it, në fund të vitit 2019, është e plotësuar me masën 94% të numrit të përgjithshëm, ku 5% të vendeve vakante i kanë kaluar të gjitha proceset e konkurrimit dhe po u nënshtrohen trajnimeve 6 mujore.

Në SHISH, 77% e punonjësve janë meshkuj dhe 23% femra, çka dëshmon përparim në respektimin e barazisë gjinore, pavarësisht se mbetet ende për t'u bërë në këtë drejtim.

Drejtuës në SHISH janë 13% të numrit total të punonjësve, ndërsa 3% e tyre janë drejtuese femra.

Mosha mesatare e punonjësve të SHISH-it për vitin 2019 ishte 44 vjeç.



Rekrutimi i Burimeve Njerëzore në 2019

Rekrutimi i Burimeve Njerëzore është një ndër sfidat kryesore të punës në SHISH, për tërheqje të burimeve njerëzore me një kapacitet të lartë profesional, të fokusuar në rezultate dhe në përmbushjen e roleve të ndryshme, duke plotësuar nevojat dhe ruajtur balancat.

Procedura e rekrutimeve është e bazuar në

rregullore të miratuara dhe kalon të gjitha fazat si më poshtë:

Studimi paraprak të vendeve të lira në momentin e vlerësimit, në numrin mesatar të punonjësve që, për arsye familjare, shëndetësore apo të tjera, mund të kërkojnë lirin nga SHISH-i, në numrin e punonjësve

që mbushin kriteret për pension pleqërie si dhe nevojat që ka Shërbimi për burime njerëzore me aftësi apo gjuhë të rralla.


Rekrutimi për inspektor në SHISH për vitin 2019 ka kohëzgjatje për një periudhë 6 mujore deri në përcaktimin e kandidatëve fitues duke kaluar nëpër fazat që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore, e konkretisht:

Shpalljen e nevojave për punonjës në dy gazeta kombëtare me tirazh më të madh, shpallja në faqen zyrtare të internetit të SHISH-it, mbledhja e dokumentacionit të kandidatëve (aplikantëve), përgatitja e statis-

tikave të plota dhe të detajuara për të dhënat e të gjithë kandidatëve, përzgjedhja e kandidatëve që plotësojnë kriteret dhe që do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe me gojë, si dhe përcaktimi i kandidateve fitues që do t'i nënshtrohen verifikimit të kushtit të sigurisë.

Përveç pranimeve me konkurrim, në SHISH janë rekrutuar edhe shtetas që paraqesin kërkesë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet adresës transparenca@shish.gov.al ose kur rekomandohen nga punonjës të SHISH-it dhe paraqesin cilësi të veçanta e të kërkuara nga ana jonë.

Fazat e Rekrutimit



Trajnimet

Për arritjen e objektivave të ngarkuara, njësitë e ndryshme në SHISH e kanë të domosdoshme kryerjen e vazhdueshme të trajnimit të punonjësve nga strukturat e brendshme të SHISH-it, institucionet e sigurisë në vend, shërbimet partnere në kuadër të bashkëpunimit dhe institucione të tjera.

Për vitin 2019, janë trajnuar në kurse afatgjata 1 deri 4 muaj 3.6% e punonjësve, si dhe trajnimi 6 mujor i kandidatëve për inspektor në SHISH zë rreth 4% të numrit të përgjithshëm.

Trajnimeve afatshkurtra 1-3 ditore u janë nënshtuar afro 40% e punonjësve aktualë.

Studimi mbi rinovimin e Burimeve Njerëzore për periudhën 2020-2023

SHISH-i po përgatit një studim strategjik mbi rinovimin e burimeve njerëzore për një periudhë 3 vjeçare (2020-2023), me fokus:

- të evidentojë dhe të paraqesë gjendjen aktuale të strukturës së moshave të gjithë

personelit efektiv të Shërbimit dhe, në veçanti, të punonjësve të linjës informative;

- të parashtrojë drejtimet dhe prioritetet e punës për rinovimin dhe reformimin e këtij personeli.

BASHKËPUNIMI BRENDIA DHE JASHTË VENDIT

Në kuadër të realizimit të detyrave ligjore dhe prioriteteve, gjatë kësaj periudhë SHISH ka forcuar bashkëpunimin me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese për parandalimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale e antiligjore, të tilla si:

- terrorizmi ndërkombëtar
- trafiku ndërkombëtar i lëndëve narkotike
- rrjetet e favorizimit të emigracionit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore

- pastrimi i produktit kriminal
- kontrabanda dhe evazioni fiskal
- korrupsioni në nivele të larta në administratën shtetërore dhe në sistemin e drejtësisë etj.

Bashkëpunimi me agjencitë ligjzbatuese gjatë 2019 ka sjellë rezultate konkrete dhe të matshme në luftën ndaj krimit të organizuar, që është konkretizuar e finalizuar me operacione dhe rezultate konkrete.



Bashkëpunimi ndërkombëtar

SHISH-i, në kuadër të interesave të ndërsjella, ka fuqizuar më tej marrëdhëniet me shërbimet informative partnere, ka thelluar bashkëpunimin ekzistues, ka krijuar bashkëpunime të reja dhe ka rritur kontributin me analiza e vlerësime për strukturat e inteligjencës dhe sigurisë së NATO-s, BE-së etj.

Gjatë 2019-ës, është rritur në mënyrë të ndeshme shkëmbimi i informacionit në nivel

strategjik dhe operacional. Fokusi kryesor për 2019 ka vijuar të jetë bashkëpunimi në fushën e kundërzbulimit, kryesisht në drejtim të veprimtarive të shërbimeve sekrete jo-miqësore ndaj vendit tonë dhe Aleancës së Atlantikut të Veriut, krimit të organizuar, trafikut të lëndëve narkotike dhe drogave të forta, veprimtarive të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, sigurisë dhe stabilitetit rajonal, etj.

Nisur nga pozicioni strategjik i vendit tonë në rajon, SHISH-i ka synuar dhe realizuar thellimin e bashkëpunimit informativ-operativ në nivel rajonal, për çështje që lidhen me sigurinë rajonale, krimin e organizuar, terrorizmin etj. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, SHISH-i ka organizuar konferenca rajonale në nivel ekspertësh, ku është shkëmbyer ekspertizë për krimin e organizuar, emigracionin e paligjshëm dhe sfidat e shërbimeve të inteligjencës për parandalimin e goditjen e këtyre fenomeneve. Bashkëpunimi ndërkombëtar është thelluar në nivel drejtuesish e ekspertësh, në takime në formate dy e shumëpalëshe, si dhe duke qenë pjesë aktive e konferencave dhe seminareve ndërkombëtare të sigurisë dhe inteligjencës.

Shërbimi ka vijuar gjithashtu të japë kontributin e tij në takime plenare të formateve shumëpalëshe rajonale e ndërkombëtare, të tilla si “SEEIC”, “MEC”, “ADRIACLUB” etj., ku janë trajtuar probleme të kërcënimeve nga terrorizmi, emigracioni i paligjshëm, siguria energjetike, veprimtaria e aktorëve të

tretë dhe shërbimeve tyre të inteligjencës në rajon etj.

Vlen të theksohet kontributi i SHISH-it, në kuadër të Komitetit të Inteligjencës Civile të NATO, me kontribute konkrete në fushën e terrorizmit në Ballkanin Perëndimor, veprimtaritë e shërbimeve kundërshtarë dhe proxit e tyre, aktivitetet hibride etj.

Në kuadër të forcimit të marrëdhënieve dypalëshe, SHISH-i ka rritur numrin e përfaqësuesve, duke atashuar oficerë ndërlidhës në shtete me të cilat ndajmë sfida dhe kërcënime të përbashkëta. Kjo ka ndikuar në rritjen dhe rritur thellimin e bashkëpunimeve si dhe forcimin e marrëdhënieve me shërbimet informative të shteteve ku janë akredituar.

Në këtë kuadër, SHISH-i ka thelluar bashkëpunimin informativ e operacional edhe nëpërmjet koordinatorëve të SHIVH-ve, të akredituar në vendi tonë.

Nisur nga qasja dhe ekspertiza rajonale, SHISH-i ka luajtur dhe vazhdon të luajë rol pozitiv në sigurinë rajonale, në luftën ndaj ekstremizmit e terrorizmit dhe ka marrë në vijimësi feedback pozitiv nga shërbimet partnere.



SHISH-I NË NISMA SOCIALE DHE HUMANITARE

Shërbimi Informativ i Shtetit është i angazhuar në nisma dhe veprimtari me karakter social e humanitar. SHISH-i nxit vullnetarizmin dhe veprimtaritë humanitare mes punonjësve të tij.

Gjatë vitit 2019, punonjësit e SHISH-it iu bashkuan nismës së Kryqit të Kuq Shqiptar për dhurimin vullnetar të gjakut. Nën asistencën e strukturave të Kryqit të Kuq, dhjetëra punonjës dhuruan gjak në ndihmë të lehtësimit të një shqetësimi mjaft serioz, siç është mungesa e gjakut të mjaftueshëm në spitalet tona, si dhe në shprehje të humanizmit dhe mbështetjes ndaj fëmijëve talasemikë. Të dhurosh gjak do të thotë të japësh shpresë, të shpëtosh jetë dhe punonjësit e SHISH-it janë të vetëdijshëm se, gjaku është jetik, nuk mjafton kurrë dhe kërkohet në çdo kohë për përdorim të menjëhershëm. Prej disa vitesh, punonjësit e



Shërbimit konsiderohen dhurues të rregullt të gjakut dhe janë vlerësuar e përshëndetur edhe nga Kryqi i Kuq për mbështetjen që japin.

* * *

Dhurimi i gjakut nuk ishte i vetmi angazhim social i SHISH-it. Në fund të vitit, punonjësit e SHISH-it u angazhuan në një fushatë disaditore për mbledhjen dhe dhurimin e fondeve në ndihmë të të dëmtuarve nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Në çdo njësi të Shërbimit, u grumbulluan fonde për t'u ardhur sadopak në ndihmë familjeve që humbën banesat apo u gjendën në kushte të vështira sociale-ekonomike pas fatkeqësisë natyrore. Shuma e mbledhur nga punonjësit e SHISH-it u depozitua pranë llogarisë së krijuar nga qeveria shqiptare për të mbështetur të prekurit nga tërmeti.



Festa e Vitit të Ri

Me rastin e festave të fundvitit, SHISH-i hapi dyert për fëmijët. SHISH-i i kushton rëndësi trajtimit e gjendjes së punonjësve e familjeve të tyre, ndaj përpiqet të stimulojë vlerat më të mira të shoqërisë mes socializimit. Ne jemi të vetëdijshëm se, gjatë gjithë vitit, kemi krijuar një borxh kohor me më të vegjlit e familjeve tona, ndaj vendosëm t'i ftojmë ata në prag të Vitit



të Ri për të festuar së bashku. Fëmijët sollën hare në institucion, ata festuan për orë të tëra mes figurave të dashura të lojërave e ëndrrave të tyre dhe na kujtuan se u detyrohemi shumë. Ata meritojnë një vend më të mirë e më të sigurt,

ndërsa prindërit e tyre përpiqen çdo ditë të realizojnë misionin e një institucioni të rëndësishëm të sigurisë kombëtare, siç është SHISH-i.



LISTA E SHKURTESAVE

AISM - Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
AKSHI - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
BE - Bashkimi Evropian
DPPSH - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPPPP - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
DATAK - Departamenti i Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit
DVP - Drejtoritë Vendore të Policisë
INTERPOL - Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
ISIL/DAESH - Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë
IT&T - Teknologji e Informacionit dhe Telekomunikimit
LHT - Luftëtar i Huaj Terrorist
MEC - Konferenca e Evropës Qendrore
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
MM - Ministria e Mbrojtjes
MEPJ - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MD - Ministria e Drejtësisë
MIE - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MENA - Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut (Middle East and North Africa)
NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OJQ - Organizatë Joqeveritare
PKR - Prokuroria e Krimeve të Rënda
PP - Prokuroria e Përgjithshme
PRRGJ - Prokuroria e Rrethit Gjyqësor
SEEIC - Konferenca e Inteligjencës së Evropës Juglindore
SHÇBA - Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
SHISH - Shërbimi Informativ i Shtetit
SHIVH - Shërbime Informative të Vendeve të Huaja
TATP - triacetone triperoxide (lëndë shpërthyesë)
TAP - Projekti i Gazsjellësit Transadriatik
VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave

Ky dokument është pronësi e SHISH-it. Botohet me qëllim informimin e publikut të përgjithshëm mbi veprimtarinë e SHISH-it, mbi sfidat dhe kërcënimet me të cilat përballet vendi. Dokumenti është publik, gjendet edhe në format elektronik në adresën tonë www.shish.gov.al. Teksti dhe figurat mund të përdoren për arsye studimore e informuese, duke cituar detyrimisht burimin.

Kontakt:

Tel: +355 69 4138387

Email: transparenca@shish.gov.al

Adresa postare: Rruga “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, Shqipëri
www.shish.gov.al

TIRANË - 2020